



E PRANUAR 26.04.2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	26.04.2017
REFERENC-Ë:	34/4
PËR/ZA/TO:	HIM-group Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
GA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Rekomandimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr.180 të dt.21.04.2017 për kërkesën e HIM-group nga Prizreni.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Rekomandimit.

6 m-m-s-n-k 26.04.2017

[Handwritten signature]



180

21.04.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sports
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve / Kosovo Institute for Protection of
Monuments / Institut Kosova za Zastitu Spomenika

DATË/A:	19.04.2017
REFERENC-Ë:	08/2017 - Takimi i tetë
PËR/ZA/TO:	Z. Agim GËRGURI - U.D. Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve. <i>[Signature]</i>
CC:	Z. Bislim BISLIMI - Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit / DL MKRS, anëtar i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM; Znj. Zana LLONÇARI OSMANI- Zyrtare e Lartë në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore - MKRS, anëtare e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM;
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Znj. Teuta SELMANAJ - Zyrtare Ligjore në IKMM, përgjegjëse për mbështetjen administrative të punës së Komisionit. <i>[Signature]</i>
NGA/OD/FROM:	Znj. Merita AUGUSTININRECAJ- Kryesuese e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimet e Komisionit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave / projekteve: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren

I nderuar Drejtor z. Gërguri,

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore (në tekstin e mëtejme Komisioni) i emëruar me Vendimin Nr. 01/2016 të datës 13.04.2016, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin tjetër Nr. 52/2016 të datës 04.10.2016 me Nr. të protokollit 376, ka zhvilluar takimin e tetë(8) punues me datë 03.04.2017, ku janë shqyrtuar kërkesat dhe projektet e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK)- Prizren. Janë dhënë rekomandimet si në vijm:

Rreth kërkesës Nr. 2. QRTK - Prizren:

2. Subjekti HIM - grup nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e një pjese të kompleksit për banim, në ngastrën kadastrale 1142 - 2, 1142 - 1 Z.K Prizren. Parcela ekzistuese për ndërtim nuk është në Zonën e Qendrës Historike të Prizrenit por gjendet në afërsi të Xhamisë - Namazxhahut, objekt ky në listën e MKRS-së, "Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme" (10.10.2016 - 10.10.2017). Objekti është në rrugën "Xhemil Fluku" pa numër. Nga komisioni kërkohet vlerësimi i projektit ideor për ndërtimin e këtij kompleksi të banimit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të doëzuar, komisioni cilëson se kompleksi i banimit i parapare të ndërtohet me projektin ideor të prezentuar tejkalon kriteret për ndërtim në zonat mbrojtëse të monumenteve. Kompleksi i banimit e pengon kuadrin vizuel të Xhamisë - Namazxhahut dhe e konkurrin atë në përmasë.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese - Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si më poshtë:

1. Të refuzohet kërkesa e palës për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e një pjese të kompleksit për banim, në ngastrën kadastrale 1142-2, 1142-1 ZK Prizren, i cili tejkalon kriteret për ndërtim në zonat mbrojtëse të monumenteve, të përcaktuara me Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore sipas nenit 2.21 dhe 6.4
2. Të njoftohet pala se kriteret për ndërtim në zonën mbrojtëse të Xhamisë-Namazxhahut, sa i përket ruajtjes së kuadrit vizuel të saj janë:
 - Ndërtesa e re nuk lejohet të tejkalojë lartësinë e minares së Xhamisë - Namazxhahut
 - Ndërtesa duhet të ketë arkitekturë dhe duhet të realizohet me materiale që nuk i konkurrojnë Xhamisë-Namazxhahut.